

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 19  
23.09.2014

NR. VENDIMI 18  
23.09.2014

**V E N D I M**  
**“PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE ”**

Gjykata e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej:

**KLODIAN KURUSHI – GJYQTAR**

Asistuar prej sekretares **Ermira TERBUNI**, sot më datë 23. 09. 2014  
mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur prej:

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së  
Parë për Krime të Rënda Tiranë, perfaqësuar  
nga prokurori **Anton Martini**.

**ME OBJEKT :** Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurite  
e mëposhtme:

1. Autoveturën tip “xxx“, me targa  
xxx, viti i prodhimit xxx, me numër shasie xxx,  
aktualisht në pronësi të shtetasit A.M.
2. *Apartament Tip xxx ( xxx) me sipërfaqe ndërtimi  
xxx m<sup>2</sup> e ndodhur në katin e x-të të banimit, në  
Shkallën nr.x me orientim nga Veri Perëndimi, me  
adresë xxx, Komuna xxx, xxx, të porositur dhe të  
paguar më datë xxx nga nëna e shtetasit nën hetim  
E.M., shtetesja P.M., sipas kontratës së porosisë*

me shoqërinë “xxx” shpk me përfaqësues shtetasin I.B. tek noter M.Ç. me nr. xxx rep dhe nr.xxx kol.

3. Apartamentin e numërtuar *Apartamenti*

*Nr. xx, shkalla x*, me orientim ne perëndim të objektit, midis akseve x-x dhe x-x, me sipërfaqe të përgjithshme  $xxx m^2$  me adresë xxx, Komuna xxx, xxx, të porositur dhe paguar më datë xxx nga nëna e shtetasës nën hetim K.D., shtetasja S.D., sipas kontratës së porosisë me shoqërinë “xxx” me administrator shtetasin A.Z. tek noter F.Ç. me nr. xx rep dhe nr.x kol.

**IDYSHUAR:**        1. **E.M.**, i biri i Z. dhe i P. i datëlindjes xxx, lindur në xxx dhe banues në xxx, i cili po hetohet për veprat penale të “**Shtërgimit me anë të kanosjes për dhënie pasurie**” kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/b-25 të Kodit Penal në dy raste në dëm të shtetasve **A.Xh.** dhe **E.H.**

2. **K.D.**, e bija e M. dhe e S., e datëlindjes e xxx, lindur në xxx dhe banuese në xxx, e cila po hetohet për veprën penale të “**Shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë**” në bashkëpunim në dy raste në dëm të shtetasve

**A.Xh.** dhe **E.H.** parashikuar nga neni 109/b – 25 i Kodit Penal.

**BAZA LIGJORE:**        Neni 274 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, gjykata pasi administroi aktet dhe provat bashkëngjitur kërkesës, dëgjoi prokurorin i cili kërkoi të pranohet kërkesa sipas objektit të saj, si dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi

## V Ë R E N

Gjykata me vendimet me nr. xxx dhe xxx datë xxx ka caktuar masat e sigurimit “arrest në burg” ndaj të hetuarve K.D. dhe E.M. Të hetuarit dyshohen se në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë kryer veprën penale të “**Shtërgimit me anë të kanosjes për dhënie pasurie**” kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/b-25 të Kodit Penal në dy raste në dëm të shtetasve **A.Xh.** dhe **E.H.**

### *Rrethanat e faktit*

Më datë xxx pranë Seksionit të Vjedhjeve me Dhunë dhe Armë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut xxx ka bërë kallëzim shtetasi A.Xh., i datëlindjes xxx, me banim në xxx, me profesion xxx. Ky shtetas ka kallzuar se në lagjen e tij ku banon në rrugën “xxx” këtu në xxx, kishte njohur para disa kohësh një vajzë me emrin K. e cila punonte në një pikë llotarije sportive për llogari të një shtetasi me emrin E., i cili në vijim i është prezantuar si bashkëshorti i saj. Pas njohjes më këtë vajzë, kallëzuesi tregon se ka vijuar kontaktet me të duke u takuar në disa raste jashtë ambienteve të punës së saj. Në takimin e datës xxx me kërkesë të shtetasës K., kallëzuesi ka deklaruar se është diktuar nga shtetasi E. i cili i është prezantuar si bashkëshorti i saj. Vendi i takimit me shtetasin E. ka qënë rruga afër Universitetit “xxx”, ku ky i fundit nëpërmjet kërcënimit ka marrë me forcë në makinën e tij, si kallëzuesin ashtu dhe shtetasen K. dhe i ka dërguar në afërsi të fshatit xxx. Në këtë vend, ai ka zbritur nga makina kallëzuesin dhe duke e kërcënuar për takimin që sipas tij ka bërë me bashkëshorten e tij, i ka kërkuar në formë “gjobe” fillimisht një sasi prej xxx eurosh e në vijim një sasi më të vogël atë prej xxx eurosh. Kallëzuesi pretendon se ka pranuar kërkesën e shtetasit E., me qëllim shmangien e konfliktit me të, dhe sipas bisedës së bërë në këto kushte, ai duhet t`i japë shtetasit E. sasinë e parave të kërkuara prej tij deri në datë xxx.

Shtetasi E. është identifikuar si shtetasi E.M. ndërsa shtetesja me emrin K. si shtetesja K.D. të cilët janë marrë dhe si persona nën hetim për këtë ngjarje.

Më datë xxx, pranë Sektorit për Krime të Rënda Ndaj Jetës dhe Pronës në Drejtorinë e Policisë së Qarkut xxx, më datë xxx është paraqitur dhe ka bërë kallëzim i dëmtuari E.H., banor i qytetit xxx, me profesion xxx. Në kallëzimin e tij ai është shprehur se gjatë muajit qershor xxx është njohur me një shtetase me emrin K.D. nga xxx, e cila punonte si kamariere në lokalin me emrin “xxx” në

zonën e njohur si “xxx”, këtu në xxx. Njohja midis tyre ka avancuar dhe më datë xxx kanë vendosur të lëvizin së bashku nga xxx me autoveturën e kallzuesit tip “xxx” me targa xxx.

Në dalje të qytetit xxx për në drejtim të qytetit xxx në afërsi të një karburanti, makinës që drejtohej prej kallzuesit ku brenda saj gjendej edhe shtetasja K.D., i është prerë rruga nga një makinë me xhama të zinj, nga ku ka dalë shtetasi E.M. banor i qytetit xxx me armë zjarri pistoletë në dorë dhe duke e kanosur kallzuesin për vrasje. Në vijim, kallzuesi nën presionin e armës së zjarrit tregon se ka zbritur nga timoni i makinës së tij dhe është zhvendosur në vendin e parë, ndërsa nga vendi i parë i makinës ka lëvizur dhe shtetasja K. duke kaluar mbrapa në sedilje ndërsa makinën e marrë për ta drejtuar shtetasi E.

Më pas ata kanë shkuar në drejtim të “xxx” dhe kanë devijuar rrugën kryesore duke lëvizur në një rrugë të pa asfaltuar kanë përfunduar në afërsi të një liqeni të vogël. Si rrugës dhe në vendin ku ndaloi makina shtetasi E. sipas kallzuesit ka vijuar kërcënimin duke pretenduar se e kishte fyer pasi shoqërohej me gruan e tij me të cilën bashkëjetonte. Në këtë vend, po sipas kallzuesit shtetasi E. ka qëlluar dy herë me pistoletë për ta kërcënuar dhe duke i bërë presion atij i ka kërkuar si shpagim ndaj veprimeve të tij, t`i jepte makinën si dhe një shtëpi për të cilën ai ishte në dijeni se kallzuesi merrej me ndërtime.

I ndodhur në këto kushte, kallzuesi shprehet se ra dakort me të t`i jepte makinën dhe një shtëpi, por me qëllim që ai ta linte të qetë. Më pas shtetasi E. e ka detyruar kallzuesin sipas deklarimeve të tij të bëjë një fotografi duke u përqaftuar me shtetasen K. e cila ishte aty. Kjo fotografi sipas kallzuesit do të shërbente për shtetasin E. si mjet shantazhi te familja, e kryesisht tek bashkëshortja e tij. Po ashtu, shtetasi E. sipas kallzuesit kërcënonte edhe shtetasen K. dhe e ka qëlluar me shuplakë disa herë duke u munduar të krijojë idenë se ajo nuk ishte pjesë e skenarit të përgatitur më parë prej tyre, po një viktimë e dhunës së të dyshuarit E.

Në vijim, kallzuesi deklaroi se makinën e mësipërme po atë ditë ja ka shitur shtetasit E. në shumën prej x(x) milion lekë duke bërë kontratën tek noteri, por pa marrë para prej tij. Pas rreth një jave, shtetasi E. i ka marrë pa para një apartament kallzuesit sipas thënieve të tij, i cili ndodhet në zonën e njohur si “xxx”, këtu në xxx. Dy javë më pas, sërish shtetasi E. me kërcënimin se fotografinë e bërë prej tij me shtetasen K. do t`ja jepte gruas së tij i ka kërkuar një shtëpi për K. dhe e ka marrë po në zonën e njohur si “xxx” me sipërfaqe xx

m2.

Në muajin gusht xx shtetasi E. sipas kallëzuesit i ka marrë sërish një sasi prej xxx eurosh duke pretenduar se i duheshin për të mbyllur një çështje gjyqësore që kishte të hapur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor xxx.

Kërcënimet e shtetasit E. sipas kallëzuesit nuk përfundojnë me marrjen e sendeve dhe parave të mësipërme, pasi nga muaji shtator xxx deri në muajin shkurt xxx atij i ka marrë edhe një sasi tjetër prej xx mijë eurosh të tjera, në total xx mijë euro.

Më datë xxx procedimet e mësipërme janë bashkuar duke u njohur me numër procedimi penal xxx, për vitin xxx.

Prokuroria ka vazhduar më tej hetimet në drejtim të identifikimit dhe individualizimit të pasurive që dyshohet se kanë përfituar të hetuarit si rezultat i shtrëngimit që ata kanë kryer ndaj shtetasit E.H.. Më konkretisht:

Në vijim të hetimeve ka rezultuar se shtetasi nën hetim E.M. autoveturën e tipit “xxx” me targa xxx të cilën ja ka marrë kallëzuesit E.H. (*nën kërcënim me kontratën e datës xxx bërë tek noteri S.J. me nr. xxx rep dhe xxx kol*) e ka ndërruar me një autoveturë tjetër të markës xxx me targa xxx, viti i prodhimit xxx, me numër shasie xxx. Këtë autoveturë e ka regjistruar në emrin e bashkëshortes së tij, shtetases E.Gj., e bija e Gj., e datëlindjes xxx, banuese në xxx dhe më pas i ka ndërruar targat nga xxx në xxx. Këto fakte provohen me këto dokumenta:

Kontratë e shitblerjes së autoveturës datë **xxx** bërë tek notere N.K. me nr. xxx rep dhe nr. xxx kol, ku shtetasi nën hetim E.M. ja shet bashkëshortes së tij, shtetases E.Gj. autoveturën e tipit **“xxx” me targa xxx**. Pasi regjistrohet në emrin e shtetases E.Gj., autoveturës së mësipërme i ndërrohen targat nga xxx në xxx.

Me kontratën e shitblerjes së autoveturës datë **xxx** bërë tek notere Sh.Gj., me nr. xxx rep dhe nr. xxx kol, shtetësja E.Gj. ja shet shtetasit A.H. autoveturën e tipit **“xxx” me targa xxx**.

Po më datë **xxx** me kontratën e shitblerjes së autoveturës bërë tek notere Sh.Gj., me nr. xxx rep dhe nr. xxx kol, shtetësja E.Gj. e blen nga shtetasi A.H.

autoveturën e tipit **xxx me targa xxx**, viti i prodhimit xxx, me numër shasie xxx. Me pas i ndërron targat nga **xxx në xxx. (Pra është realizuar praktikisht një ndërrim automjetesh mes shitësve dhe blerësve ndaj njëri – tjetrit).**

Më pas me kontratën noteriale me nr. xxx rep dhe nr. xxx kol, datë xxx bërë tek notere N.K. këtë autoveturë shtetesja E.Gj. ja jep në përdorim bashkëshortit të saj shtetasit nën hetim E.M.

Pas ardhjes në dijeni të hetimeve e kryesisht të kallzimit të të dëmtuarit E.H., shtetasi nën hetim E.M. me qëllim fshehjen e kësaj autoveture nga frika e sekuestrimit dhe konfiskimit të saj, me kontratën e kaparit datë xxx bërë tek notere E.H., me nr. xxx rep dhe nr. xxx kol, shtetesja E.Gj. ja shet shtetasit **A.M.** autoveturën e tipit **xxx me targa xxx** në shumën xxx euro ku pala blerëse në momentin e lidhjes së kontratës i ka dhënë vetëm shumën prej xxx lekë.

Lidhur me apartamentet e deklaruara nga **i dëmtuari E.H.** të përfituara nga veprimet e dyshuara si kriminale të shtetasve nën hetim E.M. dhe K.D. rezultuan nga hetimi këto të dhëna:

Me datë **xxx** shtetasi nën hetim **E.M.** ka lidhur një kontratë porosie me shoqërinë **“xxx” shpk** tek notere M.Ç. me nr. xxx rep dhe nr. xx kol, **për një apartament Tip xxx (xxx) me sipërfaqe ndërtimi xxx m<sup>2</sup> e ndodhur në katin e x-të të banimit, në Shkallën nr.x, me orientim nga Veri Përendimi, me adresë xxx, Komuna xxx, xxx.**

Me datë **xxx** shtetasi nën hetim **E.M.** ka revokuar kontratën e mësipërme me shoqërinë **“xxx” shpk** dhe ka vendosur nënën e tij P.M. si porositëse të kësaj banese me qëllim fshehjen e emrit të tij nga kjo pasuri.

Me datë **xxx nëna e shtetasit nën hetim E.M., shtetesja P.M.,** ka lidhur një kontratë porosie me shoqërinë **“ xxx” shpk me përfaqësues shtetasin I.B. tek noter M.Ç. me nr. xxx rep dhe nr.xxx kol për një apartament Tip xxx ( xx) me sipërfaqe ndërtimi xxx m<sup>2</sup> e ndodhur në katin e x-të të banimit, në Shkallën nr. x, me orientim nga Veri Perëndimi, me adresë xxx, Komuna xxx, xxx.**

Me datë **xxx** shtetesja nën hetim **K.D.,** ka lidhur një kontratë porosie me shoqërinë **“xxx” shpk** me administrator shtetasin A.Z. tek noter F.Ç. me nr. xx rep dhe nr. x kol për një apartament të numërtuar **Apartamenti Nr. xx, në**

**shkalla x, me orientim ne përendim të objektit, midis akseve x-x dhe x-x, me sipërfaqe të përgjithshme xxx m<sup>2</sup> me adresë xxx, Komuna xxx, xxx.**

Me datë xxx shtetesja nën hetim **K.D. ka revokuar kontratën e mësipërme me shoqërinë “xxx” shpk** dhe ka vendosur nënën e saj **S.D.** si porositëse të kësaj banese me qëllim fshehjen e emrit të saj nga kjo pasuri.

Me datë xxx nëna e shtetases nën hetim **K.D.**, shtetesja **S.D.**, ka lidhur një kontratë porosie me shoqërinë “xxx” me administrator shtetasin **A.Z. tek noter F.Ç. me nr. xx rep dhe nr. x kol për një apartament të numërtuar Apartamenti Nr.xx, në shkalla x, me orientim ne përendim të objektit, midis akseve x-x dhe x-x, me sipërfaqe të përgjithshme xxx m<sup>2</sup> me adresë xxx, Komuna xxx, xxx.**

Si në rastin e shtetasit nën hetim **E.M.** ashtu dhe në rastin e shtetases **K.D.**, paratë për apartamentet e porositura në kontratat e sipërcituara ishin paguar që në momentin e lidhjes së kontratës, por sipas deklarimit të përfaqësuesve të shoqërive **A.Z.**, etj, shtetasit nën hetim nuk kanë dhënë para, por këto shtëpi kanë qënë të të dëmtuarit **E.H.**, i cili ka mbylluar ai detyrimet me shoqëritë dhe nën kontraktorët e tyre.

### ***Ligji i zbatueshëm***

### **Kodi i Procedurës Penale**

*Neni 274*

#### ***Objekti i sekuestros preventive***

- 1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.*
- 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sende, produktet e veprës penale dhe cdo lloj pasurie që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.*
- 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata me kërkesën e palëve e heq sekuestron.*

### ***Argumentimi ligjor***

Pasuritë e përmendura më lart që dyshohet se janë të përfituara fillimisht prej të hetuarve janë pasuri që mund të këne rrjedhur nga veprimtaria e përbashkët e të hetuarve K.D. dhe E.M. Aktualisht këto pasuri të dyshuara si të përfituara padrejtësisht nga shtetasit nën hetim E.M. dhe K.D. nëpërmjet kërcënimit ndaj të dëmtuarit E.H. dhe të transferuara tek prindërit e tyre dhe shtetasi A.M. kanë rrezik të humbasin ose të tjetërsohen me qëllim fshehjen e tyre.

Këto pasuri mund të konfiskohen sipas nenit 36 të K.Penal, pasi dyshohet se janë produkt i veprimeve kriminale për të cilat hetohen shtetasit nën hetim E.M. dhe K.D.. Rrjedhimisht gjykata çmon se këto pasuri duhet të vendosen në sekuestro preventive në funksion të procedimit penal të nisur nga prokuroria.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata bazuar në nenin 36/1/b të Kodit Penal dhe 274 të Kodit të Procedurës Penale

### **VENDOSI**

- Pranimin e kërkesës.
- Sekuestrimin preventiv mbi pasuritë e mëposhtme:
  1. Autoveturën tip “xxx“, me targa xxx, viti i prodhimit xxx, me numër shasie xxx, aktualisht në pronësi të shtetasit A.M.
  2. Apartament *Tip xx (xx) me sipërfaqe ndërtimi xxx m<sup>2</sup>* e ndodhur në katin e x-të të banimit, në Shkallën nr.x me orientim nga Veri Perëndimi, me adresë xxx, Komuna xxx xxx, të porositur dhe të paguar më datë xxx nga nëna e shtetasit nën hetim E.M., shtetesja P.M., sipas kontratës së porosisë me shoqërinë “xxx” shpk me përfaqësues shtetasin I.B. tek noter M.Ç. me nr. xxx rep dhe nr.xxx kol.
  3. Apartamentin e numërtuar *Apartamenti Nr. xx, shkalla x*, me orientim ne perëndim të objektit, midis akseve x-x dhe x-x, me sipërfaqe të përgjithshme *x m<sup>2</sup>* me adresë xxx, Komuna xxx, xxx, të porositur dhe paguar më datë xxx nga nëna e shtetasit nën hetim K.D., shtetesja S.D., sipas kontratës së porosisë me shoqërinë “xxx” me administrator shtetasin A.Z. hartuar tek noter



F.Ç. me nr. xx rep dhe nr. x kol.

- Urdhërohet Policia Gjyqësore në varësi të Prokurorisë “Për Krime të Rënda” Tiranë të ekzekutojë këtë vendim.
- Kundër vendimit lejohet apel në Gjykatën e Apelit “Për Krime të Rënda” Tiranë brenda 10 ditëve duke filluar ky afat nga dita e dhënies së vendimit për palën e pranishme dhe nga dita e njoftimit të këtij vendimi për palën në mungesë.

*U shpall në Tiranë më datë 23. 09. 2014.*

**SEKRETARE**

**Ermira TERBUNI**

**GJYQTAR**

**Klodian KURUSHI**